



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2022:150996

Datë: 24.03.2023

Numri i dokumentit: 04119469

**E. nr.101/22**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike përmbartimore të Kreditorve M. K., F. D. dhe D.Z. dhe Z. K. të punësuar në Gjimnazin “H. B.” në M. të cilët me autorizim i përfaqëson Av.Zahir Hamza nga Prishtina kundër Debitorit Komuna e Malishevës (debitori), i përfaqësuar me autorizim nga avokati publik Mujë Sahitaj, e duke vendosur për prapsimin e parashtruar nga debitori kundër aktvendimit **E. nr.101/22** i datës 18.10.2022 të kësaj gjykate, me datë 24.03.2023, mori këtë:

**A k t v e n d i m**

- I. **REFUZOHET si i papabazuar** prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës, i ushtruar ndaj Aktvendimit të kësaj Gjykate E. nr.101/22 i datës 18.10.2022, ashtu që;
- II. **Mbetet në Fuqi Aktvendimi E. nr.101/22 i datës 18.10.2022** i kësaj gjykate mbi lejimin e përmbartimit në emër të shujtave ditore dhe atë për të gjithë kreditorët shumën prej 952.00 euro si dhe për shpenzimet e procedurës në shumën prej 690.00 euro.

**A r s y e t i m**

Gjykata me Aktvendimin E. nr.101/22 i datës 18.10.2022 e ka lejuar propozimin e Kreditorve M.K., F. D. dhe D. Z. për përmbartim sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë C.nr.1104/2021 të datës 21.04.2022 i plotfuqishëm me datë 13.05.2022 në emër të shujtave ditore në shumën e përgjithshme prej 952.00 €, si dhe për shpenzimet e procedurës në shumën prej 690.00.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit me dt.09.12.2022, në afatin ligjor ka ushtruar prapësim debitori, duke e kontestuar propozimin për përmbartim të këtij aktgjykimi tani në këtë fazë të procedurës, pasi i njëjti nuk mund të përmbrohët sipas nenit 29 të LPP-së dhe nuk është dokument i përshtatshëm për përmbartim për vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT, dhe kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi që palët të cilat e kanë nënshkruar këtë

kontratë, nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruaj këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, gjykatës i ka propozuar të aprovohet kundërshtimi i Komunës së Malishevës, të pezullohet procedura për këtë çështje përmabrimore dhe të shtyhët ky përmbarim.

I autorizuari i kreditorëve brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilin ka theksuar se pretendimet e cekura në prapësim nuk përkojnë me fazën procedurale ku jemi, andaj dhe konsiderojmë se nëse lëshohemi në këto pretendime kontestimore shkelët parimi i legalitetit rigoroz formal, gjykatës i ka propozuar të refuzohet në tërësi prapësimi i Komunës së Malishevës si i pa bazuar

Duke vlerësuar shkresat e lëndës e sidomos pretendimet e prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të ushtruar nga kreditori, Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është **i pa bazuar**.

Sipas nenit 71 të LPP-së, të Ligjit nr. 04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 të datës 31.01.2013, më tej LPP), janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi e të cilat shkaqe po që se ekzistojnë, pengojnë përmbarimin e lejuar nga gjykata. Gjykata vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, në fakt dokumenti mbi të cilin është mbështetur Urdhri mbi lejimin e përmbarimit ka titull ekzekutiv (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1), dokumenti përmbarues (titulli ekzekutiv) nuk ka humbur efektin e tij me ndonjë vendim tjetër institucional, (neni 71. Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2) në bazë të cilit është marr me aktvendim përmbarues nuk është prishur, anuluar apo ndryshuar, shfuqizuar në një mënyrë të tjetër dhe nuk e ka humbur efektin e tij juridik, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3) palët për mes dokumentit përmbarues janë pajtuar që ti kryen obligimet e tyre për kohe të caktuar, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4) nuk ka skaduar afati kohor ku palët mund të kërkojnë përmbarimin, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5) objekti i përmbarimit nuk është i përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6) kreditori është i autorizuar që në bazë të dokumentit përmbarues të kërkojë përmbarimin kundër debitorit, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9) realizimi i kredisë nuk është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër në mënyrë të përhershme ose për periudhën e kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk ka mundur të bënte të njohur në procedurë në të cilin është nxjerrë vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdie në Gjykatë ose në organin administrativ, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10) kërkesa nga dokumenti përmbarues nuk është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve, e sidomos duke pasur parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, debitori nuk ka ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetët pretendimet e tij, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së, sipas dispozitës të cekur është paraparë se provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim për ndryshe prapësimi do të refuzohet.

Gjykata konstatoj se pretendimet e debitorit theksuar si më lart përkatësisht si në kundërshtimin e datës 09.12.2022 nuk qëndrojnë pasi Kreditori propozimit për përmbarim ja ka bashkangjitur Aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.1104/2021 të datës 21.04.2022, i cili Aktgjykim është në origjinal, i plotfuqishëm nga data 13.05.2022, dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili thotë : *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se*

*është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”, sipas nenit 21 të LPP-së i cili thotë : “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, sipas nenit 22 par. 1., pika 1.1., ku thotë : “Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese”, sipas nenit 23. par.1., i cili thotë “vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore”, neni 24 par. 1., i cili thotë “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, prandaj pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë si të arsyeshme sepse prapësimi nuk ja ka bashkëngjitur as edhe një provë të vetme me shkrim, e sipas nenit 69 par. 4 i cili thotë: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, andaj mbështetur në këto gjykata një deklaram të tillë të debitorit nuk e aprovoi, pasi që kemi të bëjmë me vendim gjyqësor i cili është titull ekzekutiv i bashkangjitura propozimit për përmbarim, i cili i plotëson të gjitha kushte e parapara sipas nenit 22 par. 1., pika 1.1., të LPP-së.*

Gjykata shqyrtoi kërkesën e debitorit lidhur me shtyrjen e përmbarimit, por gjykata të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar, pasi që në kuptim të dispozitave të nenit 60 të LPP-së nuk është përmbushur asnjëri nga kushtet e përcaktuara të cilat e determinojnë shtyrjen e përmbarimit, dhe që debitori nuk ka parashtuar asnjë provë me anë të të cilës do t’a bënte të besueshme kërkesën e tij dhe prova me anë të të cilit do të bindte gjykatën se ndaj titullit përmbarimor është ushtruar ndonjë mjet juridik me të cilën do të mund të pezullonte dhe ndryshonte titullin përmbarimor.

Andaj në kuptim të nenit 5 par. 5, neni 21, neni 22 par. 1, nën par. 1.1, neni 23. par.1, neni 24 par. 1, nenet 37, 38, 61, 69 paragrafi 4, si dhe nenet 71, dhe 73 paragrafi 3 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm.**  
**E.nr. 101/22 me dt.24.03.2023**

**Gjyqtari**  
Nehat Qelaj

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.